

REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA E KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA E KOSOVËS - VLADA KOSOVA - GOVERNMENT OF KOSOVO
MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME - MINISTARSTVO UNUTRAŠNJIH POSLOVA
MINISTRY OF INTERNAL AFFAIRS
Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Zbiranje / Generalni Sekretarati
Office of the Secretary General

Nr./Br./No. 689 / Nr./Br./No./No. pg. 1
Data/Dejmi/Date 28.09.2018
PRISHTINE - PRISTINA - PRISTINA



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Punëve të Brendshme / Ministarstvo Unutrašnjih Poslova / Ministry of Internal Affairs

Nr. 689 /2018
Datë: 28/09 /2018

Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Punëve të Brendshme,
Në mbështetje të nenit 38 të Ligjit nr. 03/L-189 për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës, (Gazeta Zyrtare, Nr. 82, 21 tetor 2010), nenin 38 (5) të Rregullores nr. 09/2011 për Punë të Qeverisë së Kosovës (Gazeta Zyrtare, nr. 15, 12 shtator 2011), dhe nenin 17 (5 dhe 6) të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive (Gazeta Zyrtare, nr. 1, 18 prill 2011) nxjerr:

V E N D I M

1. z. Erdon Arifaj, Udhëheqës i Sektorit të Gjendjes Civile në ARC, caktohet Zyrtar Përgjegjës për hartimin e Projekt Udhëzimit Administrativ për Ndryshimin dhe Plotësimin e Udhëzimit Administrativ (MPB) Nr.01/2015 për Përdorimin e Kopjeve të Certifikuara të Regjistrave Origjinal Themeltar të Gjendjes Civile të Kosovës, të cilat janë marrë nga ish pushteti serb, para qershorit të vitit 1999., (në tekstin e mëtejme: Zyrtari Përgjegjës)
2. Gjatë hartimit të draftit fillestar të projekt aktit nënligjor, zyrtari përgjegjës duhet t'iu përmbahet rregullave dhe procedurave të parashikuara në Rregulloren Nr. 09/2011 të Punës së Qeverisë, Rregulloren Nr.13/2013 për Shërbimin Ligjor Qeveritar si dhe dispozitave të Udhëzimit Administrativ Nr.03/2013 për Standardet e Hartimit të Akteve Normative.
3. Përveç hartimit të draftit fillestar, zyrtari përgjegjës është i obliguar të administrojë tërë procesin e konsultimeve paraprake dhe publike sipas nenit 7 dhe 32 të Rregullores Nr. 09/2011 të Punës së Qeverisë dhe Rregullores Nr.13/2013 për Shërbimin Ligjor Qeveritar.
4. Zyrtari Përgjegjës në bashkëpunim me personelin e Departamentit Ligjor dhe zyrtarët tjerë përkatës të Ministrisë së Punëve të Brendshme, Zyrës Ligjore të ZKM-së si dhe ministrive përkatëse, përgatitë edhe dokumentet dhe kushtet e kërkuara me Rregulloren Nr. 09/2011 të Punës së Qeverisë.
5. Afati kohor për përfundimin e draftit fillestar nga Zyrtari Përgjegjës është sipas Planit Legjislativ për Aktet Nënligjore të MPB-së për vitin 2018.

6. Pas përfundimit të hartimit të draftit fillestar dhe dokumentacionit tjetër shoqërues sipas pikës 3 të këtij vendimi, Zyrtari Përgjegjës aktin nënligjor duhet ta dorëzojë pesëmbëdhjete (15) ditë para afatit të paraparë në pikën 5 të këtij vendimi, tek Drejtori i Departamentit Ligjor i cili nëse nuk ka vërejtje, draftin e procedon tek Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Punëve të Brendshme.

7. Obligohen të gjitha njësitë përkatëse të Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe zyrtarët për bashkëpunim dhe ofrimin e të dhënave të kërkuara nga Zyrtari Përgjegjës.

8. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

**Lulzim Ejupi**

Sekretar i Përgjithshëm

Vendimi i dërgohet:

- *Kabinetit të Ministrit të MPB-së;*
- *Drejtorit të Përgjithshëm të ARC-së;*
- *Drejtoratit të Gjendjes Civile;*
- *Drejtorit të DL-MPB-së;*
- *Zyrtarit Përgjegjës;*
- *Arkivit të MPB-së.*